



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 14.02.2025

Nr: 96

Ora: 12:00

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV BAZUAR NË DENONCIMIN ME NR. 9 ID,  
DATË 10.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË PARTISË  
DEMOKRATIKE**

Sot më datë 14.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

**KËRKUES:** Partia Demokratike

**OBJEKT:** Shpërdorimi i burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore.

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, “n”, pikës 2, të nenit 136, ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 83 të Kodit të Procedurës Administrative, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**KONSTATOJ:**

Data: 14.02.2025

Nr: 96

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ, bazuar në denoncimin me nr. 9 ID, datë 10.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Partisë Demokratike

Partia Demokratike, ka paraqitur denoncimin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, më datë 10.02.2025, nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 9 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon:

*“Drejtuesit politik të Partisë Socialiste kanë shkuar në Greqi dhe Itali për tu takuar me emigrantët. Dyshimi jonë dhe i shoqërisë civile konsiston se drejtuesit politik të Partisë Socialiste gjatë takimeve të tyre janë duke shpërdoruar burimet publike, në forma të ndryshme, për të ndikuar emigrantët në zgjedhje..”.*

Duke qenë se denoncimi nuk përmbante prova të mjaftueshme për të vijuar më tej hetimin administrativ, i'u kërkuar përfaqësuesit ligjor të Partisë Demokratike të paraqesë prova të tjera shtesë, mbi rastin objekt hetimi administrativ.

Brenda afatit ligjor nuk u administruan prova të tjera mbi rastin objekt hetimi administrativ.

Sa më sipër, bazuar në nenin 82, të Kodit të Procedurës Administrative, *“Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.”*, e drejtë kjo që duhet ushtruar nga kërkuesi, Partia Demokratike.

Në seancën publike Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vlerësoj kërkesën e Partisë Demokratike, duke i dhënë kohën e mjaftueshme për të paraqitur prova shtesë për objektin shqyrtim administrativ. E drejtë e cila nuk u ushtrua nga kërkuesi, Partia Demokratike.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, “n” dhe pika 1/a, e nenit 143 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar,

### **V E N D O S:**

1. Pushimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit nr. 9, datë 10.02.2025, të Partisë Demokratike.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**